



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu

Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin “EMITT” në Stamboll/Turqi

Me qëllim të promovimit të potencialeve turistike të Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) promovon bizneset e sektorit të turizmit në panairin ndërkombëtar “EMITT” në Stamboll/Turqi datë 08.02.2023-11.02.2023.

Paraqitja shtetërore organizohet nga MINT përkatësisht KIESA, e cila mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e shtandit, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor etj, ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Ju lutem vini re se vetëm shprehjet e interesimit të dërguara deri me datë 23.12.2022 dhe vetëm aplikacionet e plotësuara tërësisht mund të konsiderohen për vlerësim.

1. Për të aplikuar duhet dorëzuar:

- 1.1. Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues; dhe
- 1.2. Dokumentet e kërkuara.

2. Dokumentet e domosdoshme për aplikim:

- 2.1. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
- 2.2. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
- 2.3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
- 2.4. Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë).
- 2.5. Deklaratën nën betim;

2.6. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2021 nga Administrata Tatimore e Kosovës; dhe

2.7. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e veçanta të listuara më poshtë.

3. Dhjetë(10) subjektet pjesëmarrëse do të përzgjidhen sipas kriterëve të veçanta si në vijim dhe rangimit të pikëve:

3.1. Produktet turistike inbound që do të ju ofrohen turistëve gjatë vitit 2023, maksimum dhjetë (10) pikë: një (1) pikë për një (1) produkt turistik inbound, tre (3) pikë për dy produkte turistike inbound, pesë (5) pikë për tri (3) produkte turistike inbound, shtatë (7) pikë për katër (4) produkte turistike inbound dhe dhjetë (10) pikë për pesë (5) e më shumë produkte turistike inbound;

3.2. Njohuria e gjuhëve të huaja dhe aftësi prezantuese të përfaqësuesve të subjektit pjesëmarrës në panair, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: gjuha Turke pesë (5) pikë, gjuha Angleze katër (4) pikë dhe gjuhët tjera një (1) pikë;

3.3. Materiale promovuese në gjuhët e huaja, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: në gjuhën Turke pesë (5) pikë dhe pesë (5) pikë në gjuhën Angleze apo Spanjolle, Italiane apo Frënge.

3.4. Aktiviteti primar turistik i subjektit, maksimum dhjetë (10) pikë: agjencion turistik katër (4) pikë dhe tour operatorë dhjetë (10) pikë;

3.5. Paraqitja e subjektit aplikues në panair e në periudhën 2018-2022, maksimum dhjetë (10) pikë: një (1) panair dy (2) pikë, dy(2) panair katër (4) pikë, tre (3) panair gjashtë (6) pikë, katër (4) panair tetë (8) pikë dhe pesë (5) e më shumë panair dhjetë (10) pikë.

Më 14.12.2022 në ora 13:30, në sallën e takimeve të KIESA-s, ekspertët e KIESA-s do të organizoj sesion informues dhe do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe për mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë në mënyrë elektronike atë më së largu deri më 23.12.2022 në e-mail adresën Export.Kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në MINT/ KIESA apo të shkarkohen nga faqet e internetit mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën Export.Kiesa@rks-gov.net.